



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1723/2 prot

Datë 09/08/2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË
TJERË

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-35180-07-04-2022, me objekt: “*Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi*”, me fond limit 4,103,333 lekë pa, TVSH, zhvilluar me datë 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.

Skualifikimin e operatorit ekonomik “2AT” SHPK, pasi ngrihen pretendime se operatori ekonomik me dokumentacionin e paraqitur, nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik”, pika 2.3.4.

Ankimues:

“Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Adresa: Rruga e Kavajës, Buka S.H.A, Nr. 8240, Njësia Nr.6 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a

Adresa: Rruga “Tasi Dema”, Fier.

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “2AT” SHPK

Adresa: Korçë-Dishnicë

Në datën 08.08.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike me numër ankimi elektronik A/2022/2431 dhe me numër nr. 1723 protokollit e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-35180-07-04-2022, me objekt: “*Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi*”, me fond limit 4,103,333 lekë pa, TVSH, zhvilluar me datë 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “2AT” SHPK, pasi ngrihen pretendime bazuar në nenin 93 të LPP-së se ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët dhe nuk ka arritur të japë shpjegime bindëse në lidhje me anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose metodës së ndërtimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, e cila kundërshtohet në ankesën me 1723 prot., datë 08.08.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyeja e skualifikimit:

“1. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi pronesine ose marrjen me qera te mjetit autobot, me kapacitet mbartës mbi 3 ton, për transportin e lëndëve kimike me rrezikshmëri të lartë, sipas përcaktimit të pikës 2.3.7 të DST (Kapaciteti Teknik).”

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori tjetër ekonomik “2AT” SHPK pjesmarrës në procedurë.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushjen e shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik”, pika 2.3.4: Ofertuesi duhet te

paraqesi certifikaten e analizes nga Instituti i Shendetit Publik, ose deshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuarra për lëshimin e tyre, për analize toksikologjike për NaOCl. (hipoklorit natriumi) të marre brenda 3 muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.:

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 09.08.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri